

UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.2.2023

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Kualifikimi i mësuesve organizohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Organizimi i kualifikimit të mësuesve udhëhiqet nga parimi i transparencës, meritokracisë dhe barazisë për situata objektive të njëjta.

Neni 2

Organizimi i procesit të kualifikimit

1. Procesi i kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist) kryhet nëpërmjet portofolit të zhvillimit profesional të mësuesve dhe provimeve me test sipas lëndëve/profileve dhe cikleve përkatëse.
2. Procesi i kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër) kryhet nëpërmjet portofolit të zhvillimit profesional të mësuesve dhe provimit të realizuar me orë mësimore të hapur në lëndën/profilin dhe ciklin përkatës.

Neni 3

Provimi për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar)
dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Provimi i kualifikimit të kandidatëve të kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist):
 - a) zhvillohet me shkrim me një kohëzgjatje dy orë e tridhjetë minuta në mjediset e përcaktuara nga ASCAP-i;
 - b) administrohet nga ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në dhe DRAP-të.

Neni 4

Zhvillimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër)

1. Zhvillimi i orës mësimore të hapur të kandidatëve të kategorisë I (Mësues mjeshtër) organizohet në mjediset e shkollës përkatëse të kandidatit me një klasë të caktuar.
2. ZVAP-ja, në bashkëpunim me drejtuesit e rrjeteve profesionale, harton kalendarin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura dhe e miraton atë për të gjithë kandidatët sipas periudhës së përcaktuar nga MAS-i.
3. Drejtuesi i rrjetit profesional siguron pjesëmarrjen e anëtarëve të rrjetit profesional në orën mësimore të hapur të zhvilluar nga kandidati mësues sipas kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja.
4. Ora mësimore e hapur zhvillohet nga kandidati mësues në prani të drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional si dhe të drejtuesit të shkollës që mbulon lëndën/profilin përkatës.

5. Në përfundim, ora e hapur vlerësohet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Kriteret e pranimit

1. Kandidatët për kualifikim (kandidatët) janë punonjësit e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërt me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimi fizik.

2. Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:

- a) të paktën 5 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”;
- b) të paktën 10 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe të paktën 5 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të paktën 20 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër” dhe të paktën 10 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues specialist”.

3. Punonjësit arsimorë, të përmendur në pikën 2, që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe kategorisë së kualifikimit, kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.

4. Duke filluar nga viti shkollor 2014-2015 e në vazhdim, mësuesit që plotësojnë kriteret e pikës 2 të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit, nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnimi në vit kalendarik, të cilat janë të barasvlershme me 18 orë trajnimi të pasqyruara me 1 (një) kredit.

Neni 6

Parimet bazë të procedurave të provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Procedura e provimit të kualifikimit bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) Ruajtja e fshehtësisë së fondit të pyetjeve dhe të testeve.
- b) Korrektesa e kandidatëve në mjedisin e provimit.
- c) Korrektesa e administrimit.
- ç) Vlerësimi i standardizuar i përgjigjeve të kandidatëve.

Neni 7

Parimet bazë të provimit për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër)

1. Zhvillimi i orës mësimore të hapur bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) kreativiteti;
- b) inovacioni;
- c) profesionalizmi;
- d) gjithëpërfshirja;
- e) efektiviteti.

KREU II

DETYRAT E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE DHE TË KANDIDATËVE

Neni 8

Detyrat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton programet orientuese për kualifikimin sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë orientime rreth njohurive dhe aftësive bazë që duhet të zotërojnë mësuesit për provimin e kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist), orientime rreth formatit të orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër), referencat e literaturës që përbëhen nga akte ligjore e nënligjore dhe udhëzues të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Pjesa tjetër e literaturës përzgjidhet nga mësuesit që do të marrin pjesë në kualifikim;

b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesin e testit dhe vlerësuesit e testeve;

c) realizon seanca informuese me hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit e testeve, vlerësuesit e testeve dhe me përgjegjësit e administrimit të provimit, për zhvillimin e këtyre proceseve;

d) harton formatet e procesverbaleve të parashikuara në këtë udhëzim që lidhen me provimin e kualifikimit;

e) përcakton mjediset ku do të zhvillohen provimet në bashkëpunim me DPAP-në;

f) cakton numrin e kandidatëve në provim sipas mjediseve përkatëse;

g) njofton secilën drejtori rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) për numrin e punonjësve të saj ose punonjësve të zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) në varësi të tyre që do të luajnë rolet e përgjegjësit të administrimit të provimit, administratorit dhe sekretuesit;

h) përcakton kriteret e vlerësimit me pikë të kërkesave të testit dhe të pjesëve të tij;

i) përdor barkode për sekretimin e testeve të provimit;

j) monitoron procesin e organizimit të provimeve;

k) organizon dhe kryen përmes vlerësuesve procesin e vlerësimit të kandidatëve për përgjigjet e testeve;

l) dërgon në DRAP/ZVAP listën e vlerësimeve për çdo pjesëmarrës, me pikët për të dyja pjesët e testit dhe vlerësimin me fjalë të tij;

m) monitoron procesin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-të dhe ZVAP-të;

n) harton bazën e të dhënave përfundimtare për të gjithë kandidatët në procesin e kualifikimit;

o) harton raportin e ecursisë së procesit të kualifikimit dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për arsimin;

p) i paraqet ministrit përgjegjës për arsimin rekomandime për politikat dhe planet e zhvillimit profesional të personelit mësimor bazuar në rezultatet e provimit të kualifikimit.

Neni 9

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton listën përfundimtare të përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve për administrimin e provimit të kualifikimit sipas mjediseve dhe numrit të përcaktuar nga ASCAP-i;

b) verifikon dhe monitoron saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

c) verifikon dhe monitoron vlerësimin e kriterëve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

d) monitoron vlerësimin e portofolit të mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse.

e) monitoron procesin e zhvillimit të orëve të hapura, në bashkëpunim me ASCAP-in, DRAP-të dhe ZVAP-të.

Neni 10

Detyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton listën e emrave të të gjithë kandidatëve që do të marrin pjesë në kualifikimin e mësuesve për DRAP-në dhe e dërgon në ASCAP sipas bazës së të dhënave të përcaktuar së bashku me pikët e portofolit;

- b) verifikon dhe monitoron plotësinë dhe saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit;
- c) verifikon dhe monitoron procesin e vlerësimit të kritereve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;
- d) monitoron vlerësimin e portofolit të mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;
- e) monitoron procesin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura në bashkëpunim me ASCAP-in, DPAP-në dhe ZVAP-të.
- f) harton listën e emrave të përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve për provimet e kualifikimit dhe i dërgon në DPAP;
- g) dërgon zyrtarisht në ASCAP, në formë elektronike dhe me shkresë zyrtare, bazën e të dhënave të plota sipas formatit të ASCAP-it;
- h) organizon seminare rreth rezultateve të kualifikimit në DRAP;
- i) përmirëson planin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë mbështetur në rezultatet e provimeve.

Neni 11

Detyrat e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

- a) informon kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit;
- b) njofton kandidatët që të paraqesin kërkesën për kualifikim dhe portofolin profesional;
- c) shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura;
- d) vlerëson me pikë portofolet e kandidatëve nga komisione të ngritura në ZVAP;
- e) njofton secilin kandidat dhe drejtorinë përkatëse të institucionit arsimor për vlerësimin me pikë të portofolit;
- f) dërgon në DRAP listën emërore të të gjithë kandidatëve me pikët e portofolit, sipas bazës së të dhënave të përcaktuara nga ASCAP-i;
- g) njofton secilin kandidat për datën, mjedisin dhe orën e zhvillimit të provimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist);
- h) njofton për rezultatet në provim secilin kandidat dhe drejtorinë përkatëse të institucionit arsimor;
- i) njofton në bashkëpunim me drejtuesin e rrjetit profesional secilin kandidat për datën e zhvillimit të orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër);
- j) siguron pjesëmarrjen në orën mësimore të hapur të drejtuesit dhe të dy anëtarëve të rrjetit profesional, si dhe të një përfaqësuesi të saj;
- k) përgatit instrumentin përkatës për vlerësimin e orës mësimore të hapur, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga drejtuesi i rrjetit profesional dhe drejtuesi i institucionit arsimor përkatës, si dhe nënshkruhet nga mësuesi kandidat;
- l) mbledh të gjitha vlerësimet për orët mësimore të hapura të zhvilluara nga kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër) dhe i ruan ato sipas legjislacionit në fuqi;
- m) monitoron procesin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura në bashkëpunim me ASCAP-in, DPAP-në dhe DRAP-të;
- n) plotëson bazën e të dhënave me pikët e vlerësimit për kandidatët për kategorinë I;
- o) hedh në bazën e të dhënave të personelit mësimor të dhënat e reja të kualifikimit të mësuesve.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatit të kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist) në provim

1. Ditën e zhvillimit të provimit, kandidati duhet të respektojë rregullat e mëposhtme:

- a) të jetë i pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- b) të paraqitet së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit;
- c) të mos mbajë dhe të mos përdorë telefonin celular dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo përbën kriter skualifikimi;

- d) të mos pije duhan dhe të mos konsumojë ushqime në mjediset e provimit;
 - e) të mos komunikojë me të tjerët gjatë zhvillimit të provimit.
2. Kandidatit që nuk paraqitet në provim, ose tërhiqet përpara fillimit të tij, provimi nuk vlerësohet si i kryer.
 3. Kandidati që hyn në provim dhe tërhiqet nga provimi pa e përfunduar atë, skualifikohet.
 4. Kandidati që del nga salla e provimit nuk rihyn në sallë gjatë zhvillimit të provimit.
 5. Mjediset ku zhvillohet provimi, monitorohen nëpërmjet strukturave të sigurimit të cilësisë së ASCAP-it.

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatit të kategorisë I (Mësues mjeshtër)

1. Kandidati realizon orën mësimore të hapur vetëm në ditën e përcaktuar në kalendarin e ZVAP-së duke respektuar orarin përkatës.
2. Për zhvillimin e orës mësimore të hapur, kandidati duhet të ketë parasysh:
 - a) të përgatisë paraprakisht planifikimin e orës mësimore të hapur dhe t'ua vë në dispozicion pjesëmarrësve;
 - b) të vë në dijeni drejtorinë e institucionit arsimor për klasën me të cilën do të zhvillojnë orën mësimore të hapur;
 - c) të përgatisë paraprakisht mjedisin e klasës ku do të zhvillohet ora mësimore e hapur;
 - d) të diskutojë me pjesëmarrësit cilësinë dhe efektivitetin e realizimit të orës mësimore të hapur.

KREU III

ORGANIZIMI I KUALIFIKIMIT

Neni 14

Portofoli i kandidatit

1. Portofoli personal i kandidatit përmban këto dokumente:
 - a) Jetëshkrimi (me fotografi).
 - b) Fotokopje e noterizuar e certifikatave me kreditet përkatëse.
 - c) Fotokopje e noterizuar e dëshmive të titujve/gradave shkencore (nëse ka).
 - ç) Fotokopje e noterizuar e dëshmive të mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka).
 - d) vlerësimi i fundit i drejtorit të institucionit arsimor.
2. Portofoli profesional i kandidatit përmban këto dokumente autentike dhe origjinale:
 - a) Plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup klasash, organizuar nga kandidati përkatës, të realizuar gjatë vitit të kualifikimit, të shoqëruar me realizimin e aktivitetit me foto etj.
 - b) Planifikimi i një ore mësimi model (ditar) duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin sipas kurrikulës me kompetenca.
 - c) Testi/detyra përmbledhëse për një periudhë të caktuar, sipas profilin përkatës, të realizuar gjatë vitit të kualifikimit, të shoqëruar me një analizë të thjeshtë të rezultateve të arritura në një klasë të caktuar.
 - ç) Plani i një projekti kurrikular të zhvilluar nga nxënësit e një klase të caktuar, të shoqëruar me realizimin e tij me foto.
 - d) Gjuha e huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, ose në provime ndërkombëtare të njohura sipas akteve ligjore në fuqi.
 - e) Diploma: diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to me 60-120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Diploma e ciklit të dytë nuk përfton pikë, nëse vlen si kriter arsimimi për profesionin e mësuesit.
3. Vlerësimi i portofolit profesional:
 - a) Komisioni i Vlerësimit të Portofolit (KVP), i ngritur nga titullari i ZVAP-së, vlerëson me pikë secilin dokument të portofolit profesional, sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij.

b) Kandidati që nuk fiton të paktën 1 pikë për çdo dokument të shkronjave a, b, c, ç, të pikës 2 të këtij neni, ose nuk i dorëzon ato, nuk merr pjesë në provimin e kualifikimit ose në orën mësimore të hapur për kategorinë e parë.

Neni 15

Programet orientuese të kualifikimit

1. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve hartohen nga ASCAP-i dhe vihen në dispozicion të kandidatëve nga ZVAP-të.
2. Programet orientuese të kualifikimit publikohen edhe në faqen zyrtare elektronike të ASCAP-it.
3. Programi orientues i kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.
4. Programi orientues i kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.
5. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve të arsimit të mesëm të ulët, të gjimnazit, të shkollave të specializuara, si dhe të mësuesve të kulturës së përgjithshme në arsimin e orientuar, bazohen në të gjitha programet e lëndëve që japin në shkollë.
6. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve që japin lëndët profesionale në shkollat artistike, bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit pamor dhe baletit.
7. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve që japin lëndët e kulturës profesionale në shkollat speciale ose për mësuesit ndihmës, hartohen sipas programeve të përgatitura nga ASCAP-i.
8. Mësuesit e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë që japin më shumë se një lëndë, do t'i nënshtrohen procesit të kualifikimit për lëndën në të cilën zhvillojnë më shumë orë mësimore vjetore gjatë vitit të kualifikimit. Për raste të veçanta, është kompetencë e ZVAP-së të vendosë në cilën lëndë do të kualifikohet mësuesi.

Neni 16

Testet e provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Testet e provimit të kualifikimit janë:
 - a) Testi i arsimit parashkollor.
 - b) Testi i arsimit fillor.
 - c) Testi i arsimit të mesëm të ulët për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari, TIK, edukim fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit mësimor, sipas kërkesave nga ZVAP-të.
 - ç) Testi i gjimnazit dhe i kulturës së përgjithshme të shkollave të orientuara dhe speciale për lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor sipas kërkesave nga ZVAP-të.
 - d) Testi për specialitetet “Muzikë”, “Art pamor” dhe “Balet” në kulturën profesionale në shkollat e orientuara artistike.
 - e) Testi i përgjithshëm për mësuesit e kulturës profesionale në shkollat speciale ose për mësuesit ndihmës.
2. Testet hartohen nga grupe të ngritura nga drejtori i ASCAP-it, të përbëra nga specialistë dhe mësues sipas profileve përkatëse, të cilët nënshkruajnë kontratën me drejtorin e ASCAP-it.
3. Një test i provimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:
 - a) Pjesa e parë përmban dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësuesve, programet përkatëse lëndore, metodologjinë e mësimdhënie-nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, etikën, sjelljen dhe komunikimin e mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
 - b) Pjesa e dytë përfshin përmbajtjen shkencore të lëndës sipas programit të kualifikimit përkatës.

Ora mësimore e hapur për kandidatët e kategorisë I (mësues mjeshtër)

1. Ora mësimore e hapur për procesin e kualifikimit të kandidatëve të kategorisë I (Mësues mjeshtër) ndërtohet sipas planifikimit ditor duke përfshirë risi metodologjike për realizimin e rezultateve të të nxënit si dhe risi në procesin e të nxënit.
2. Orët mësimore të hapura për procesin e kualifikimit janë:
 - a) Orë mësimore e hapur për arsimin parashkollor.
 - b) Orë mësimore e hapur për arsimin fillor.
 - c) Orë mësimore e hapur për arsimin e mesëm të ulët për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari, TIK, edukim fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit mësimor, sipas kërkesave nga ZVAP-së.
 - c) Orë mësimore e hapur për gjimnazin dhe për kulturën e përgjithshme të shkollave të orientuara dhe speciale për lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor sipas kërkesave nga ZVAP-së.
 - d) Orë mësimore e hapur për specialitetet “Muzikë”, “Art pamor” dhe “Balet” në kulturën e orientuar në shkollat artistike.
 - e) Orë mësimore e hapur për mësuesit e arsimit special ose për mësuesit ndihmës.

Administrimi i provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Përgjegjësit e administrimit të provimit, administratorët dhe sekretuesit janë punonjës të DRAP/ZVAP-ve ose persona të caktuar nga titullari i DRAP-së dhe miratuar nga DPAP-ja.
2. ASCAP-i i dorëzon përgjegjësit të administrimit të provimit fletë-testet në ASCAP;
3. Përgjegjësi i administrimit të provimit:
 - a) organizon zhvillimin korrekt të provimit bashkë me administratorët që mbulon;
 - b) dorëzon fletë-testet përkatëse të secili nga administratorët që ai mbulon;
 - c) zëvendëson një administrator me një nga administratorët rezervë, kur e sheh të nevojshme;
 - d) përjashton një kandidat nga provimi, kur ai shkel rregullat e provimit;
 - e) lejon të futen në mjediset e provimit vetëm personat e autorizuar nga ministri;
 - f) harton procesverbalin dhe ia dorëzon atë përfaqësuesit të ASCAP-it.
4. Administratori i provimit:
 - a) organizon zhvillimin korrekt të provimit;
 - b) respekton orarin e zhvillimit të provimit;
 - c) sigurohet, përpara fillimit të provimit, për identitetin e kandidatit nëpërmjet dokumentit të tij të identifikimit;
 - d) sigurohet që çdo kandidat është ulur në vendin e paracaktuar;
 - e) njeh kandidatët me rregullat e zhvillimit të provimit dhe masat disiplinore;
 - f) u shpërndan fletë-testet kandidatëve;
 - g) nuk lejon asnjë person të paautorizuar të futet në mjedisin e provimit;
 - h) njofton menjëherë përgjegjësin e administrimit kur shfaqen parregullsi që cenojnë mbarëvajtjen e provimit;
 - i) dorëzon te përgjegjësi i administrimit fletë-testet e përfunduara bashkë me fletë-testet e papërdorura;
 - j) harton procesverbalin e provimit dhe ia dorëzon përgjegjësit të administrimit.
5. Në përfundim të provimit të kualifikimit, përgjegjësi i administrimit i dorëzon përfaqësuesit të ASCAP-it kutinë me fletë-testet dhe materialet e provimit.

**Mjediset e provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar)
dhe të kategorisë II (mësues specialist)**

1. Në një mjedis provimi vendosen vetëm kandidatët e një apo disa ZVAP-ve sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.
2. Në hyrje të çdo mjedisi provimi, në një vend të dukshëm, shpallet lista e kandidatëve në atë mjedis dhe vendi i secilit kandidat.
3. Në mjedisin e provimit, kandidatët qëndrojnë jo më pak se 1,5 m larg njëri-tjetrit.
4. Në ditën e provimit, në godinën ku zhvillohet provimi nuk kryhet asnjë veprimtari tjetër.
5. Në mjedisin e provimit lejohen të hyjnë ose të qëndrojnë vetëm:
 - a) përgjegjësi i administrimit të provimit;
 - b) administratori;
 - c) sekretuesi;
 - d) monitoruesi si dhe persona të autorizuar nga ministri.
6. Numri i kandidatëve për 1 administrator është jo më i madh se 15.
7. Për numër të madh kandidatësh caktohen administratorë rezervë.
8. Një sekretues mbulon jo më shumë se 60 kandidatë.

Korrektesa në provimin e kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Kandidati nuk lejohet:
 - a) të marrë ose të japë informacion ose kopje nga një kandidat tjetër;
 - b) të komunikojë me një kandidat tjetër;
 - c) të bëjë komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të provimit;
 - ç) të mbajë celular ose mjet tjetër të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;
 - d) të plotësojë testin me laps;
 - dh) të shkruajë në fletën e provimit ndonjë shënim tjetër përveç çfarë kërkon testi;
 - e) të ketë me vete materiale të tjera, si: libra, fletore, fletë të bardha etj.;
 - f) të ndërrojë vendin e paracaktuar;
 - g) të mos dorëzojë testin tek administratori.
2. Kandidati, që ka shkelur një nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “dh”, “e”, “f” dhe “g”, të pikës 1 të këtij neni, sipas raportimit me shkrim të administratorit, skualifikohet nga provimi dhe nuk fiton kategorinë e kualifikimit.
3. Kandidatit që ka shkelur secilin nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “c” ose “d” të pikës 1 të këtij neni, i ulen 10 pikë nga vlerësimi i testit.
4. Administruesi ndalohet:
 - a) të japë kopje ose të lejojë të kopjohet;
 - b) të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit;
 - c) të largohet nga mjedisi i provimit duke lënë kandidatët pa një zëvendësues;
 - ç) të komunikojë me kandidatin për përmbajtjen e testit;
 - d) të shfletojë ose të bëjë shënime në materialet e provimit, si gjatë edhe pas përfundimit të provimit.
5. ASCAP-i njofton MAS-in dhe DRAP/ZVAP-në përkatëse dhe, më pas, DRAP/ZVAP-ja njofton drejtorin e institucionit arsimor përkatës për:
 - a) hartuesin e testeve që nuk ka ruajtur fshehtësinë e testit;
 - b) vlerësuesin e testit që nuk është treguar korrekt gjatë vlerësimit të testeve;
 - c) administratorin që nuk ka zbatuar udhëzimin.
6. ASCAP-i mban procesverbal për rastet kur vëren parregullsi gjatë zhvillimit të provimit.

Sekretimi i provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Sekretimi i testeve bëhet me anë të barkodeve.
2. Në secilin test ka një vend të caktuar ku vendoset barkodi.
3. Sekretimi i testeve fillon menjëherë, pasi ka filluar procesi i provimit.
4. Sekretuesi vendos barkodin në test dhe në listën emërore të kandidatëve të përgatitur nga ASCAP. Kandidati nënshkruan pasi të ketë verifikuar emrin në listë.
5. Pas përfundimit të procesit të sekretimit, sekretuesi bën mbylljen e barkodeve të sekretimit të përdorura.

Neni 22

Vlerësimi i provimit të kualifikimit për kandidatët e kategorisë III (Mësues i kualifikuar) dhe të kategorisë II (Mësues specialist)

1. Vlerësimi i testeve kryhet në Tiranë, në mjedise të përcaktuara nga ASCAP-i, nga komisionet e vlerësimit të testeve.
2. Vlerësuesi nënshkruan kontratën me drejtuesin e ASCAP-it.
3. Komisioni i vlerësimit të testeve është i përbërë nga dy anëtarë që janë specialistë ose bashkëpunëtorë të ASCAP-it për lëndën që testohet.
4. Komisioni i vlerësuesve vlerëson me pikë secilën nga dy pjesët e testit dhe veçon testet e dyshuara për kopjim.
5. Provimi quhet i kryer me sukses nëse kandidati ka fituar të paktën 40% të pikëve për secilën pjesë të testit.

Neni 23

Shqyrtimi i testeve të dyshuara për kopjim

1. Komisioni i shqyrtimit të testeve, i ngritur nga drejtori i ASCAP-it, identifikon testet e dyshuara për kopjim dhe shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e kryer.
2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, të cilët nënshkruajnë kontratë me drejtuesin e ASCAP-it.
3. Anëtarët e komisionit nënshkruajnë procesverbalin përkatës.

Neni 24

Administrimi i orëve mësimore të hapura për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër)

1. ZVAP-ja dërgon instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur në drejtorinë e institucionit arsimor.
2. Drejtori i institucionit arsimor i dorëzon instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur drejtuesit të rrjetit profesional dhe drejtuesit të shkollës që do të marrë pjesë në orën mësimore të hapur.
3. Drejtorja e institucionit arsimor siguron mjedisin, mjete didaktike apo mjete digjitale (nëse ka në dispozicion) në funksion të kërkesave që parashtron kandidati për realizimin e orës mësimore të hapur.
4. Drejtorja e institucionit arsimor siguron pjesëmarrjen në orën e hapur edhe të ekipit lëndor, si dhe të një përfaqësuesi nga këshilli i prindërve të shkollës.
5. Drejtuesi i rrjetit profesional, përfaqësuesi i ZVAP-ë dhe drejtuesi i institucionit arsimor që do të marrë pjesë në orën e hapur, organizojnë diskutimin me pjesëmarrësit lidhur me cilësinë dhe efektivitetin e realizimit të orës mësimore, si dhe plotësojnë e nënshkruajnë vlerësimin në përfundim të kryerjes së saj.
6. Drejtori i shkollës dorëzon të plotësuar në ZVAP instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur të zhvilluar nga kandidati i kategorisë I (Mësues mjeshtër).
7. Drejtuesit e rrjeteve profesionale përfshijnë në planin vjetor të rrjetit profesional pjesëmarrjen në orët mësimore të hapura për procesin e kualifikimit.

Neni 25

Vlerësimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër)

1. Vlerësimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër) bëhet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin për vlerësimin e orës mësimore të hapur shtojca 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Vlerësimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë I (Mësues mjeshtër) shënohet në kolonën përkatëse të bazës së të dhënave që dërgohet në ASCAP për kandidatët e kualifikimit.

Neni 26

Vlerësimi i procesit të kualifikimit për të gjithë kandidatët

1. Vlerësimi përfundimtar për të gjithë kandidatët bëhet me sistemin e 100 pikëve, nga të cilat 30 pikë janë të portofolit dhe 70 pikë janë të provimit ose të orës mësimore të hapur.

2. Kandidati vlerësohet me pesë shkallë: A, B, C, D, E, që u korrespondojnë përkatësisht vlerësimeve me fjalët “Shkëlqyeshëm”; “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët”.

3. Kandidati nuk e fiton kualifikimin nëse vlerësimi përfundimtar i tij është “Dobët”.

Neni 27

Përsëritja e procesit të kualifikimit

1. Kandidati ka të drejtë të hyjë në procesin e kualifikimit për çdo kategori dhe, në rast se nuk e kalon me sukses provimin, hyn në procesin e sesionit pasardhës.

2. Kandidati që e ka fituar kategorinë e kualifikimit dhe ka dëshirë të përmirësojë rezultatin, mund ta përsërisë provimin vetëm një herë në sesionin pasardhës.

Neni 28

Certifikimi

1. Kandidati që fiton kategorinë e kualifikimit, pajiset me certifikatën në të cilën tregohet kategoria, lënda/profili, cikli si edhe vlerësimi me shkronjë i shoqëruar me përshkrim.

2. Certifikata prodhohet nga ASCAP-i dhe nënshkruhet nga drejtuesi i ASCAP-it.

3. ASCAP-i u dërgon certifikatat ZVAP-ve.

4. ZVAP-të u dorëzojnë certifikatat mësuesve përkatës.

Neni 29

Procedura e ankimit

1. Për portofolin:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim për vlerësimin tek titullari i ZVAP-së brenda tri ditëve nga vlerësimi i portofolit;

b) titullari i dërgon ankuesit përgjigjen me shkrim brenda pesë ditëve nga data e dorëzimit të ankesës;

c) përgjigja e titullarit është përfundimtare.

2. Për zhvillimin e provimit:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim, brenda tri ditëve nga data e përfundimit të provimit, te drejtuesi i ASCAP-it, për parregullsi gjatë zhvillimit të provimit ose për ndëshkimet që i janë dhënë nga administratori;

b) drejtuesi i ASCAP-it i dërgon ankuesit përgjigjen me shkrim brenda dhjetë ditëve nga data e dorëzimit të ankesës.

3. Për vlerësimin e testeve:

a) brenda tri ditëve nga data e njoftimit të rezultateve të provimeve, ZVAP-ja mbledh të gjitha ankimet me shkrim të kandidatëve për vlerësimin e provimit dhe i dërgon në formë elektronike dhe me postë në DRAP;

b) brenda tri ditëve nga marrja e ankimeve nga ZVAP-të, DRAP-ja i mbledh të gjitha ankimet nga ZVAP-të përkatëse dhe i dërgon në ASCAP në formë elektronike dhe me postë, sipas formatit të përcaktuar nga ASCAP-i;

c) nëse ankesa e kandidatit gjykohet e drejtë, testi rivlerësohet.

d) vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Testeve është përfundimtar.

e) përgjigjet e vlerësimeve përfundimtare të kandidatëve u dërgohen në formë elektronike DRAP-së dhe ZVAP-së përkatëse.

Neni 30

Konflikti i interesit

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit e testeve, vlerësuesit e testeve dhe administratorët nuk lejohet të jenë:

a) autorë të teksteve të nxënësit;

b) autorë të librave ndihmës për nxënësit ose mësuesit (përveç atyre që botohen nga institucionet vartëse të MAS-it);

c) kandidatë për kualifikimin e atij viti.

2. Hartuesi dhe vlerësuesit e testit, administratorët, anëtarët e komisioneve të shqyrtimit të testeve nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort/bashkëshorte / bashkëjetues, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/ bashkëshortes/bashkëjetuesit).

3. Hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve dhe anëtarët e komisioneve të shqyrtimit të testeve nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në ASCAP.

Neni 31

Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Aspekte financiare

1. Kandidati për kategorinë III (Mësues i kualifikuar) dhe për kategorinë II (Mësues specialist) i mbulon vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të marrë pjesë në procesin e provimit të kualifikimit.

2. Shpenzimet për hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve mbulohen nga ASCAP-i.

3. Shpenzimet për administratorët e provimeve mbulohen DPAP-ja ose DRAP-të ose ZVAP-të.

Neni 33

Objekti i inspektimit

1. Procedurat e vlerësimit të portofoleve nga ZVAP-të, procesverbalet për kryerjen e orëve mësimore të hapura dhe monitorimi i procesit të kualifikimit përfshihen në platformat e inspektimit të ASCAP-it, DPAP-së dhe DRAP-ve.

2. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim është objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Hyrja në fuqi dhe dispozita të tjera

1. Udhëzimi nr. 4, datë 26.2.2021, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

SHTOJCA 1

Formati i instrumentit për vlerësimin e orës mësimore të hapur

			Nivelet e vlerësimit					
			1	2	3	4		
Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët total për secilin përshkrues	Pikët sipas niveleve të vlerësimit				Pikët e fituara
1	Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)	Mësuesi ka planifikuar të gjitha komponentët e orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënët.	5 pikë	0-1	2-3	4	5	
		Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënët gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	5 pikë	0-1	2-3	4	5	
2	Mjedisi i të nxënët (14 pikë)	Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe .	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
		Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
3	Metodat mësimore (21 pikë)	Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodës që do të përdorë dhe stileve të të nxënët.	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
		Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
		Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
4	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)	Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënët dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
		Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënët sipas niveleve të arritjes.	5 pikë	0-1	2-3	4	5	
		Mësuesi angazhon nxënët me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënët dhe nevojave të nxënësve.	5 pikë	0-1	2-3	4	5	
5	Përdorimi i mjeteve (8 pikë)	Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Vlerësimi i përgjithshëm	70 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi _____				
Mësuesi kandidat		Drejtuasi i shkollës	Drejtuasi i rrjetit profesional	Përfaqësuesi i ZVAP-se				

SHTOJCA 2

Formati për vlerësimin e portofolit të kualifikimit të punonjësve arsimorë në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë¹

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

a	Plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup klasash, organizuar nga mësuesi përkatës të realizuar gjatë vitit të kualifikimit të shoqëruar me realizimin e aktivitetit me foto. 1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit dhe përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit 1 pikë 2. Realizimi i aktivitetit dhe arritjet e tij 1 pikë 3. Foto origjinale nga aktiviteti 1 pikë	0-3 pikë
b	Një planifikim të një mësimi model (ditar) duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin sipas kurrikulës me kompetenca; 1. Përcaktimi i rezultateve të të nxënës sipas përmbajtjes së temës/temave mësimore 1 pikë 2. Përshkrimi i teknikave të mësimdhënies dhe vlerësimit të arritjeve të rezultateve të të nxënës 2 pikë 3. Përshkrimi i niveleve të arritjes 1 pikë	0-4 pikë
c	Një test/detyrë përmbledhëse për një periudhë të caktuar, sipas profilit përkatës të realizuar gjatë vitit të kualifikimit të shoqëruar me rezultatet e arritura në një klasë të caktuar. 1. Tipet e ushtrimeve/ kërkesave. Struktura e testit/detyrës sipas niveleve. 1 pikë 2. Saktësia e pikëve për çdo tip ushtrimi/kërkesë. Konvertimi i pikëve në nota 1 pikë 3. Analiza origjinale e rezultateve të arritura në një klasë të caktuar. 2 pikë	0-4 pikë
ç	Një plan të një projekti kurrikular të zhvilluar nga nxënësit e një klase të caktuar, të shoqëruar me realizimin e tij me foto. 1. Përputhshmëria e rezultateve të të nxënës me temën e projektit 1 pikë 2. Veprimtaritë kryesore të përfshira në projekt 1 pikë 3. Realizimi i tij i shoqëruar me foto 2 pikë	0-4 pikë
d	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja) : 1) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike 3 pikë 2) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A1 2 pikë 3) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A2 3 pikë 4) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 4 pikë 5) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 5 pikë 6) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C1 6 pikë 7) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C2 7 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë dhe janë brenda fatit të vlefshmërisë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0-7 pikë
e	Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to me 60-120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit. 1. Diploma me 60-90 kredite 6 pikë 2. Diploma me 120 kredite 7 pikë 3. Doktoratë 8 pikë	0-8 pikë

SHTOJCA 3

Formati për vlerësimin e portofolit të kualifikimit të punonjësve arsimorë në arsimin parashkollor²

¹ Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt s’kualifikohet. Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 4 pikë

² Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt s’kualifikohet.

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

a	Plani i një aktiviteti të zhvilluar në bashkëpunim me prindërit 1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit 1 pikë 2. Përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit 1 pikë 3. Prezantimi i planit 1 pikë	0–3 pikë
b	Planifikimi ditor (PD) 1. Lidhja e rezultateve të të nxënit me temën ditore 1 pikë 2. Zbatimi i kërkesave të formatit të planifikimit sipas kurrikulës së re 1 pikë 3. Veprimtaritë dhe metodat aktive të të mësuarit të planifikuara nga mësuesi (të shtjelluara) 1 pikë 4. Realizimi i planifikimit ditor me foto 1 pikë	0–4 pikë
c	Planifikimi dhe zhvillimi i një teme mujore ose i projektit sipas metodologjisë me të cilën punon kopshti. 1. Struktura e planifikimit mujor/ Projektit sipas formatit të kurrikulës së re 1 pikë 2. Lidhja e rezultateve të të nxënit me trajtimin e koncepteve lëndore 1 pikë 3. Planet javore me aktivitetet e planifikuara 2 pikë	0–4 pikë
ç	Punime të fëmijëve (mundësisht të lidhura me rubrikën c) 1. Përshtatja e punimeve me grup-moshën e fëmijëve 1 pikë 2. Larmia e punimeve të lidhura me konceptet lëndore dhe veprimtari të lira të zhvilluara në kopsht 1 pikë 3. Shembuj produktesh mujore të realizuara në kuadrin e një projekti, të shoqëruara me foto 2 pikë	0–4 pikë
e	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja): 1. Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike 3 pikë 2. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A1 2 pikë 3. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A2 3 pikë 4. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1 4 pikë 5. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B2 5 pikë 6. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C1 6 pikë 7. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C2 7 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti, kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0–7 pikë
f	Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Kjo lloj diplomë nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit. 1. Diploma me 60-90 kredite 6 pikë 2. Diploma me 120 kredite 7 pikë 3. Doktoratë 8 pikë	0–8 pikë

Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 4 pikë